

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.03.2021*

**11.03.2021
Ora 10:25**

RENDI I DITËS

Projektakti “Mbi verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit të kandidimit të subjektit zgjedhor Koalicioni Aleanca - AL për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ:** **Y.Merkaj, M.Koja, A.Tenolli**
- **Parti Politike:** **S’ka**

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë fillojmë me senacën e sotme publike, në rend dite kemi dy çështje: projektvendimin “Mbi verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit të kandidimit të subjektit zgjedhor Koalicioni Aleanca” dhe projektvendimin “Mbi verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit të kandidimit të subjektit zgjedhor, Partia Aleanca Kombëtare”. Viojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Po, Sekretari për të relatuar projektaktin.

Z. Y. Merkaj: Koalicioni Aleanca është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 dhe ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka verifikuar listat shumemërore të kandidatëve të Koalicionit Aleanca dhe ka konstatuar mangësi në dokumentacion si më poshtë:


*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.03.2021*

Koalicioni nuk paraqet dokument provues për plotësimin e kërkesave të Nenit 68 të Kodit Zgjedhor. Koalicioni ka paraqitur vërtetim për zotërimin e dy mandateve në Kuvend. Partitë pjestare të Koalicionit Aleanca nuk vërtetojnë se zotërojnë bashkarisht në Kuvend numër mandatesh jo më të vogël se numëri i partive pjesëmarrëse të koalicionit. Gjithashtu nuk janë paraqitur listat mbështetëse me jo më pak se 7 mijë zgjedhës në shkallë kombëtare. Kërkesa e dorëzimit të listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore Qarku Berat nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Kërkesa e dorëzimit të listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore Qarku Dibër nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Kandidati me numër rendor 2, 3, 5 dhe 6 nuk plotësojnë kriteret për t'u regjistruar si kandidat në listën shumemërore vetëm në një zonë zgjedhore. Kërkesa për njehsimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore Qarku Elbasan nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Po kështu dhe kërkesa për një listë shumemërore të kandidatëve për zonën zgjedhore Qarku Durrës nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Kërkesa për njehsimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Kërkesa për njehsimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore Qarku Vlorë nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Kërkesa për njehsimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore Qarku Lezhë nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Kërkesa për njehsimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore Qarku Korçë nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Kërkesa për njehsimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore Qarku Fier nuk është në përputhje me

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALLARI*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.03.2021**

pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu dhe kërkesa për njehsimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore Qarku Kukës nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Kërkesa për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore Qarku Shkodër nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Kërkesa për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore Qarkut Tiranë ka mospërmbushje të dokumentacionit të kandidimit. Kandidatët për deputet me numër rendor 3, 29 i mungon kopja e dokumentit të identifikimit. Konstatohet se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit me numër rendor 2 dhe 3 të listës shumëmemërore. Formulari model 05 “Deklaratë e kandidatit” për të gjitha zonat zgjedhore është plotësuar gabim. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të kthej për plotësim dokumentacionin e kandidimit të subjektit zgjedhor Koalicioni Aleanca. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Mirë, atëherë bazuar në nenin 19 pika 1, shkronja “n” dhe 2, neni 67, 72, 73 pika 1 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si dhe Udhëzimi nr. 1 datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, vendos:

1. Kthimin për korrigjim sipas gjetjeve të renditura më sipër të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet të Koalicionit Aleanca, me shkronjat nistore AL për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
2. Dokumentacioni i korrigjuar të depozitohet brenda datës 16.03.2021 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Zbardhi materialin audio

Jonida SALILLARI




***Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.03.2021***

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
4. Kundër vendimit mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.138

***Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.03.2021*

**11.03.2021
Ora 10:30**

RENDI I DITËS

Projektakti “Mbi verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit të kandidimit të subjektit zgjedhor Partia Aleanca Kombëtare për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ:** **Y.Merkaj, M.Koja, A.Tenolli**
- **Parti Politike:** **S’ka**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Partia Aleanca Kombëtare është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 dhe ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë verifikimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për deputet të Partisë Aleanca Kombëtare dhe ka konstatuar mangësi në dokumentacion, si më poshtë:

Partia Aleanca Kombëtare nuk ka paraqitur dokument provues për plotësimin e kërkesave të nenit 68/1 të Kodit Zgjedhor për zotërimin e një mandati në Kuvend ose paraqitjen e listave mbështetëse të jo më pak se 5 mijë zgjedhësve në shkallë kombëtare. Kërkesa për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore Qarku Tiranë konstatohet se nuk është respektuar

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALIILLARI*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.03.2021**

kuota gjinore si dhe ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit dhe vërehen mos përmbushje të kërkesave ligjore për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138 të vitit 2015. Kërkesa për njehsimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore Qarku Elbasan konstatohet se ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit dhe vërehen mospërmbushje të kërkesave ligjore të depozitimit të formularëve të vetëdeklarimit. Po kështu dhe tek Qarku Beratit konstatohet se nuk është respektuar kuota gjinore, ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit dhe vërehen mospërmbushje të kërkesave ligjore për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit. Kërkesa për njehsimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore Qarku Kukës konstatohet se ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit dhe vërehen mospërmbushje të kërkesave ligjore të depozitimit të formularëve të vetëdeklarimit. Po kështu dhe Qarku Elbasan, Qarku Gjirokastrë, Dibër, Shkodër. Gjithashtu kërkesa për njehsimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet të Qarkut Durrës konstatohet se ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit dhe ka mospërputhje në depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit. Për Qarkun Fier konstatohet nuk është respektuar kuota gjinore dhe ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit dhe mos plotësimin e kërkesave ligjore për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit. Gjithashtu dhe Qarkun Vlorë, Qarku Korçë kanë të njëjtat problematika. Qarku Lezhë konstatohet se nuk është respektuar dhe kuota gjinore përveç problematikave të mësipërme. Në këto kushte i kërkojmë, i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të kthejë për plotësim dokumentacionin e kandidimit për korrigjimin e mangësive të konstatuara për subjektin zgjedhor, Partia Aleanca Kombëtare. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtimin dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Zbardhi materialin audio

Jonida SALILLARI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.03.2021*

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë bazuar në këtë relativitet si dhe nën 19 pikat 1, shkronja “n” dhe 2, si dhe nën 67, 72, 73 pikat 1 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si dhe Udhëzimi nr. 1 datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, vendos:

1. Kthimin për korrigjim sipas gjetjeve të renditura më sipër të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputetë të Partisë Aleanca Kombëtare për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
2. Dokumentacioni i korrigjuar të dorëzohet në KQZ brenda datës 16.03.2021.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Faleminderit, kjo ishte pika e fundit e rendit të ditës?

Z. Y. Merkaj: Po

Z. I. Celibashi: Seanca mbyllet!

Vendimi nr.139

Zbardhi materialin audio

Jonida SALILLARI

